



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.336/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË –Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Korporata Energjetike e Kosovës sh.a rruga Nëna Terezë nr.36-Prishtinë kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1624/17 të datës 23.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr.1624/2017 i datës 23.02.2021, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr.1624/2017 të datës 23.02.2021, është refuzuar kërkesëpadia e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.185/2017 dt.16.08.2017 të paditurës Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësja, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e paditëses si të bazuar, ndërsa Aktgjykimin A.nr.1624/2017 të datës 23.02.2021 ta ndryshoj me aprovimin e padis dhe kërkesëpadisë si të bazuar. Arsyetimi i dhënë në vendimin ë shkallës së dytë është përshkrues dhe fare nuk është bindës për arsye se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, pasi që vet objekti sipas vendimit për masa ndëshkuese është huqur, nuk janë specifikuar se cilat lëshime të paditëses ka ardhur deri te aksidenti, e pa të cilat nuk ka mundur as të vërtetohet shkaktari i aksidentit, pastaj të evidentoj shkaqet që kanë ndikuar në lëndimin e punëtorit. Punëdhënësi nuk mund të mbaj përgjegjësi për neglizhencën dhe mos përfilljen e rregullave për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, se aksidenti nuk është pasoj e lëshimit në procesin e prodhimit nga ana e punëdhënësit, vendi i punës ka qenë i ndriçuar, dyshemeja ka qenë e pastër dhe e terur, punëtori ka qene i pajisur me pajisje mbrojtëse. Paditësja nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që i aplikon inspektorati i punës, punëtori është dashur të ketë kujdes për sigurinë dhe shëndetin e vet gjatë

kryerjes se punëve dhe të veproj konform dispozitave të nenit 3 pika 2 e Ligjit 2003/19 dhe nenit 21 pika 2.4 neni 21 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Përgjigje në ankesë nuk ka në shkresat e lëndës

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë duke inicuar konflikt administrativ kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, (MPMS) respektivisht ka kundërshtuar vendimin nr.185/2017 dt.16.08.2017 të paditurës Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa drejtë dhe në kundërshtim me ligjin.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me datë 23.02.2021, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë duke u bazuar në provat siç janë: aktvendimet kontestuese të paditurës, raporti zyrtar i inspektoratit në lidhje me aksidentin në punë dt.22.05.2017, raporti nga departamenti SI dt.24.04.2017, dokumentacioni i lëndimit në vendin e punës të punëmarrësit, kartela e punëtorit, raporti mjekësor, shkresë e departamentit elektrik dhe makinerisë dt.27.04.2017 deklarate e F.H., të dhënat e dëshmitarit, andaj duke u bazuar në provat e cekura më lartë gjykata e shkallës së parë, vendosi që ta refuzoj padinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, aktgjykimin e ka mbështetur në dispozitat e nenit 42 paragrafi 2 të Ligjit të Punës 03/L-202, dhe nenit 7.5 nënp 5.6 të Udhëzimit Administrativ 07/2012 për Shqiptimin e Gjobave. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka dhënë konstatimet faktike lidhur me parregullsitë ligjore të gjetura përmes Raportit zyrtar të inspektoratit datës 22.05.2017.

Sa i përket pretendimeve ankimore se paditësja nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që i aplikon inspektorati i punës, Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara në ligj, se punëdhënësi në këtë rast paditësi ka ndërmarr masat e duhura ligjore për të siguruar kushtet ligjore që parashihen me ligj. Gjithashtu Kolegji, konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të

mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pabazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, se me Raportin zyrtar të datës 22.05.2017 gjykata vëren se gjatë kontrollit inspektues të paditësja është gjetur se punëdhënësi nuk ka krijuar kushte të sigurta dhe të shëndetshme në hapësirat e punës për parandalimin e aksidentit, ku në këtë rast punëdhënësi ka pasur detyrë të ndërmarr masat për siguri dhe shëndet përfshirë masa për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës. Kolegji i vlerëson si të pranueshme konstatimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë se punëdhënësjë –paditësja në këtë rast nuk ka arritur që pranë gjykatës të provoj se ka krijuar kushtet e parapara e të sigurta për mbrojtjen e punëtorëve në pajtim me dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 të Ligjit 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, që parasheh: Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurtë, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.

Kolegji nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, nuk janë specifikuar se cilat lëshime të paditëses kanë ardhur deri te aksidenti, e pa të cilat nuk ka mundur as të vërtetohet shkaktari i aksidentit. Meqenëse kemi të bëjmë me obligime ligjore që paditësja ka pasur në raport me punonjësin për të siguruar mbarëvajtje të rregullt të procesit të punës, dhe janë konstatuar shkeljet ligjore nga paditësja të gjetura nga inspektori i punës të konstatuara edhe në Raportin zyrtar datës 22.05.2017, paditësja me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, që gjejnë mbështetje ligjore, prandaj pretendimet ankimore nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar, Kolegji, konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësorë të dispozitave ligjore, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.336/22 datë 03.11.2022

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha